



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Rruga: Naim Frashëri, Nr 37, Tiranë, SHQIPËRI

PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL PËR EFEKT MARRJEN E
SHKALLËVE TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE TË ARSIMIT
PARASHKOLLOR
2013

1. HYRJE

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të arsimit parashkollor është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit - IZHA. Ai u vjen në ndihmë të gjitha Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave të Arsimit të rretheve, si dhe të gjithë mësuesve të arsimit parashkollor për t'u përgatitur për testimin kombëtar për marrjen e shkallëve të kualifikimit.

Programi është zhvilluar duke iu përgjigjur kërkesave që MASH-i ka vendosur për mësuesit që kualifikohen. Programi është hartuar duke mbajtur parasysh fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve:

- dokumentet zyrtare¹ të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë mësimore – edukative të mësuesve;
- standardet dhe programet e parashkollorit;
- aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë në mësimdhënie-nxënien në arsimin parashkollor;
- aspekte të etikës dhe komunikimit;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtjen shkencore të kurrikulës së arsimit parashkollor.

2. QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të arsimit parashkollor është hartuar për të mbështetur dhe nxitur zhvillimin e tyre profesional. Programi është hartuar nga grupi i punës duke mbajtur parasysh përmbushjen e dy qëllimeve kryesore:

- *Së pari*, ofrohet si një program orientues për Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat e Arsimit si dhe të gjithë mësuesve të arsimit parashkollor në arsimin parauniversitar

¹ Është fjala për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MASH që zbatohen në institucionet parashkollore.

për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese në bazë rrethi. Në këtë aspekt programi mund të plotësohet nga DAR/ZA-të përkatëse, sipas kushteve dhe mundësive konkrete.

- *Së dyti*, ai është një program i detyruar veçanërisht për mësuesit që këtë vit do të marrin kualifikimin 5, 10 dhe 20 vjeçar, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje gjithëvjetoare për të përballuar me sukses kërkesat që ka testimi kombëtar.

Programi synon:

- Rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit arsimor, e, në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformave arsimore.
- Rritjen e aftësive dhe të kompetencave profesionale të kuadrit mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e efektivitetit të veprimtarisë mësimore-edukative.
- Rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në kopsht.
- Rritjen e aftësive të mësuesve në drejtim të zbatimit me saktësi të rregullave drejtshkrimore të shqipes.
- Rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për domosdoshmërinë e njohjes së koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës.

3. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të arsimit parashkollor është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër, për të cilat testohen mësuesit. Për secilën fushë janë renditur njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojë mësuesja e arsimit parashkollor që të përmbushë me sukses rubrikat e testimit.

Programi është ndërtuar duke patur si pikënisje standardet bazë të përgjithshme të mësuesit si dhe standardet e mësuesit të arsimit parashkollor. Përshkallëzimi i kompetencave profesionale që lidhen me secilën fushë të testimit do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë nevojat e tij si dhe çështjet në të cilat duhet të thellohet më shumë.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Sipas këtij formati, për secilën fushë prezantohen kompetencat që mësuesit duhet të zotërojnë në fushën e njohurive dhe aftësive si dhe literatura përkatëse rekomanduese që u vjen në ndihmë për zotërimin e këtyre kompetencave.

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Fusha: Dokumentet zyrtare

Kjo fushë synon që mësuesi i arsimit parashkollor:

- të jetë njohës i mirë i Ligjit për arsimin parauniversitar, i Dispozitave normative dhe i Udhëzimeve të nxjerra nga MASH që rregullojnë dhe bëjnë të mundur funksionimin e gjithë sistemit arsimor parauniversitar dhe në mënyrë të veçantë të kopshtit.
- t'i interpretojë dokumentet kryesore politike të reformës arsimore të arsimit parauniversitar në situata konkrete.

Rezultati	Literatura
Mësuesi duhet të jetë i aftë:	
<ul style="list-style-type: none"> • të njohë dhe të zbatojë Ligjin për arsimin parauniversitar dhe Dispozitat normative; • të interpretojë dhe zbatojë përmbajtjen e neneve të cituara në literaturë; • të interpretojë dokumentet kryesore politike të reformës arsimore të dala gjatë këtyre viteve të fundit; • të njihet me ndryshimet që kanë ndodhur në dokumentacionin e arsimit parashkollor në Shqipëri; • të ketë njohuri rreth kërkesave të dokumentacionit shkollor, të shtruara në Ligjin për Sistemin arsimor parauniversitar, Dispozitat normative dhe në Udhëzimet e nxjerra nga MASH. 	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji Nr. 69/2012 për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë. • Dispozitat normative për arsimin parauniversitar: <ul style="list-style-type: none"> - Neni 1. Ligjet - Neni 2. Fusha e zbatimit të Dispozitave Normative - Neni 4. Synimet e kopshtit të fëmijëve - Neni 5. Kopshtet - Neni 6 Moshë - Neni 9, pika (3) Koha. Dokumentet - Neni 11 Pika (1) E drejta e regjistrimit - Neni 12 Pika (1) Ndarja territoriale - Neni 15 Puna mësimore-edukative në kopshte - Neni 16 Pika (1) Kurrikula - Neni 19 Pika 1 Grupet e përziera - Neni 20 Pika 1 Kohëzgjatja e mësimin - Neni 21. Pika 1 Vlerësimi i fëmijës parashkollor - Neni 25 Pika 1 Ndërprerja e PME-së • Udhëzimi nr 41, datë 9.11.2006 “Për zgjedhjen e literaturës ndihmëse, joartistike, në shkollat e arsimit parauniversitar”. • Udhëzimi Nr.29, dt 25.09.2007 i MASH ”Për grumbullimin, ruajtjen dhe përdorimin e të ardhurave nga dhurimet, nga prindërit e nxënësve të shkollave të Arsimit Parauniversitar”. • Udhëzimi Nr. 37, dt.09.10.2007 i MASH “Për paraqitjen e personelit të shkollës në mjediset shkollore”

	<ul style="list-style-type: none"> • Udhëzimi Nr.40, dt 17.10.2007 i MASH "Për ngritjen e funksionimin e bordit të shkollës". • Punimi i Udhëzimit të MASH, Nr. 26 datë 10.08.2010 "Për mbarëvajtjen e punës mësimore edukative në sistemin e Arsimit Parauniversitar në vitin shkollor 2010-1011. • Udhëzimi dhe rregullorja e kualifikimit të mësuesve për vitin 2011.
<p>Fusha: Programet lëndore</p> <p>Kjo fushë synon që mësuesi i arsimit parashkollor:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të reflektojë ndaj vizionit kurrikular të arsimit parashkollor; • të interpretojë dhe të punojë mbi standardet e përmbajtjes dhe të arritjes; • të kuptojë dhe të planifikojë sipas kërkesave të programeve të parashkollorit; • të njohë dhe të përdorë instrumente të ndryshme vlerësimi për arritjet e fëmijëve. 	
<p>Rezultati Mësuesi duhet të jetë i aftë:</p>	<p>Literatura</p>
<ul style="list-style-type: none"> • të analizojë standardet e përmbajtjes në arsimin parashkollor – fushat, treguesit cilësorë, fushat e veprimtarisë edukative në kopsht etj; • të njohë dhe të zbatojë: <ul style="list-style-type: none"> - parimet, - synimet, - objektivat e përgjithshme dhe specifike, - fushat e studimit, - integrimin ndërlëndor, - metodikën e zbatimit, - vlerësimin e programeve lëndorë në arsimin fillor; • të evidentojë rrisitë që mbartin programet e reja të arsimit parashkollor; • të krijojë ura bashkëpunimi, partneriteti dhe bashkëveprimi ndërmjet kopshtit e prindërve të fëmijëve sipas kërkesave që parashtrihen në Standardet e përmbajtjes; • të mbajë parasysh karakteristikat e zhvillimit tërësor të fëmijëve të moshës 3-5-vjeçare; • të vlerësojë dhe të masë në mënyrë sistematike progresin e fëmijëve. 	<ul style="list-style-type: none"> • Standardet e përmbajtjes në arsimin parashkollor, ISP 2003 • Standardet e arritjes në arsimin parashkollor, ISP 2004 • Programi i arsimit parashkollor për 3-4-vjeçarët, IKS, 2007 • Programi i arsimit parashkollor për 4-5-vjeçarët, IKS, 2007 • Programi i arsimit parashkollor për 5-6-vjeçarët, IKS, 2007 • Buletinet "Edukimi parashkollor, Nr.1-10 • Për zhvillimin profesional "Parashkollori", ISP 2003

Fusha: Aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë në mësimdhënie-nxënie

Nëpërmjet kësaj fushe synohet që mësuesi i arsimit parashkollor:

- të jetë njohës i mirë i aspekteve psikologjike, didaktike dhe pedagogjike të mësimdhënies, i stileve të të nxënit dhe i psikologjisë moshore të grup-moshës me të cilët punon.
- të hartojë plane vjetore dhe mujore duke u përqendruar në tematikat kryesore dhe në kërkesat e programeve të parashkollorit.
- të zbatojë gjatë veprimtarisë mësimore-edukative metoda e strategji ndërvepruese, si dhe praktika bashkëkohore pedagogjike.

Rezultati Mësuesi duhet të jetë i aftë:	Literatura²
<ul style="list-style-type: none">• të krijojë një mjedis nxitës dhe efektiv pune;• të njohë dhe të veprojë sipas veçorive psiko-pedagogjike të kësaj moshe shkollore (3-6 vjeç);• të analizojë elementet që i bashkojnë dhe i dallojnë programet e ndryshme edukative që zhvillohen në kopshtet shqiptare;• të menaxhojë situata, sjellje dhe veprime të ndryshme fëmijësh;• të njohë rolin dhe shprehinë profesionale që i duhen mësuesit të arsimit parashkollor;• t'i zbatojë praktikat pedagogjike në përshtatje me temën mujore, javore dhe ditore;• të organizojë projekte dhe miniprojekte me tematika të caktuara;• të planifikojë veprimtari që nxisin aftësitë krijuese të fëmijëve;• të hartojë objektiva të qarta dhe të matshëm gjatë planifikimit të veprimtarive në kopsht;• të dallojë vështirësinë në të nxënë nga aftësia e kufizuar;• të hartojë plane edukative individuale;• të përdorë mënyra të ndryshme të vlerësimit të fëmijëve.	<ul style="list-style-type: none">• Literaturë që ka në fokus metodat e mësimdhënies në nivelin parashkollor.• Udhëzues dhe materiale mbështetëse që orientojnë për hartimin e objektivave të të nxënit, përgatitjen e planit dhe organizimin e veprimtarive mësimore në nivelin parashkollor.

² Mësuesi mund të shfrytëzojë botime të ndryshme që gjenden në bibliotekë, të botuara nga organizata të ndryshme që veprojnë në fushën e edukimit ose në librari, konform kërkesave të kësaj fushe.

Fusha: Aspekte të etikës dhe komunikimit	
Rezultati Mësuesi duhet të jetë i aftë:	Literatura³
<ul style="list-style-type: none"> të njohë rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin; të sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> Kodi i Etikës së Mësuesve në Arsimin Parauniversitar publik dhe privat, i datës 12.11.2012. Literaturë dhe materiale burimore që trajtojnë çështje të etikës dhe të komunikimit.
Fusha: Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe	
Rezultati Mësuesi duhet të jetë i aftë:	Literatura⁴
<ul style="list-style-type: none"> të njohë rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe; të zbatojë rregullat e drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> Literaturë dhe udhëzues metodikë për përdorimin e rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
Fusha: Përmbajtja shkencore e lëndëve	
<p>Nëpërmjet kësaj fushe synohet që mësuesi i arsimit parashkollor:</p> <ul style="list-style-type: none"> të zotërojë të gjitha programet e parashkollorit; njohuritë, aftësitë dhe shprehjet kryesore që duhet t'u transmetojë fëmijëve 3-6-vjeçar; t'u transmetojë në mënyrën e duhur fëmijëve njohuritë, kërkesat, konceptet kryesore të programeve të parashkollorit. 	

³ Mësuesi mund të shfrytëzojë botime të ndryshme që gjenden në bibliotekë, të botuara nga organizata të ndryshme që veprojnë në fushën e edukimit ose në librari, konform kërkesave të kësaj fushe.

⁴ Mësuesi mund të shfrytëzojë botime të ndryshme që gjenden në bibliotekë, të botuara nga organizata të ndryshme që veprojnë në fushën e edukimit ose në librari, konform kërkesave të kësaj fushe.

Rezultati Mësuesi duhet të jetë i aftë:	Literatura⁵
<ul style="list-style-type: none"> • të zotërojë konceptet shkencore, dukuritë, ligjësitë që trajtohen në arsimin parashkollor në nivel shkencor dhe didaktik; • të transmetojë te fëmijët parashkollorë ato njohuri, shprehje, aftësi dhe vlera që janë në përputhje me zhvillimin e tyre dhe me kërkesat e programeve; • të realizojë objektivat e secilës fushat kurrikulare dhe t'i transmetojë saktësisht te fëmijët për nga ana shkencore e didaktike; • të zotërojë njohuritë, aftësitë dhe shprehjet që duhet të fitojnë fëmijët nga çdo fushë kurrikulare; • t'ua përshtasë kërkesat e programeve parashkollore fëmijëve që paraqesin vështirësi në të nxënë ose aftësi të kufizuar. 	<ul style="list-style-type: none"> • Programi i arsimit parashkollor për 3-4-vjeçarët, IKS, 2007 • Programi i arsimit parashkollor për 4-5-vjeçarët, IKS, 2007 • Programi i arsimit parashkollor për 5-6-vjeçarët, IKS, 2007 • Për zhvillimin profesional “Parashkollori”, ISP 2003 • Botime ndihmëse për fëmijët parashkollorë, mësuesit parashkollor, buletine dhe materiale të tjera burimore që trajtojnë përmbajtjen e kurrikulës për fëmijët parashkollorë.

⁵ Mësuesi mund të shfrytëzojë botime të ndryshme që gjenden në bibliotekë, të botuara nga organizata të ndryshme që veprojnë në fushën e edukimit ose në librari, konform kërkesave të kësaj fushe.